

GARANTIMI I AFATIT TË ARSYESHËM DHE THJESHTIMI I GJYKIMIT TË PADIVE ME VLERË TË VOGËL - RISI TË KODIT TË PROCEDURËS CIVILE

Ndër risitë kryesore të Kodin të Procedurës Civile, në kuadër të reformës në drejtësi, është përcaktimi i afateve e rregullave të reja për zhvillimin e një gjykimi dhe ekzekutimit të detyrueshëm, brenda një afati të arsyeshëm si dhe thjeshtimi i gjykimit të padive me vlerë të vogël.

Afati i arsyeshëm

⇒ Cili afat do të konsiderohet “i arsyeshëm” për përfundimin e çështjeve civile dhe administrative ?

- 2 vjet për gjykimin civil në secilën shkallë (shkallën e parë, në apel dhe në Gjykatë të Lartë);
- 1 vit për gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe 1 vit në apel;
- 1 vit për procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor civil apo administrativ.



Shkelja e afatit të arsyeshëm

⇒ Si veprohet kur shkelet afati i arsyeshëm?

- Duhet të paraqitet në gjykatë një **kërkesë për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtim të procesit;**
- **Kërkesa** bëhet vetëm për atë shkallë gjykimi apo ekzekutim të detyrueshëm, që është në vijim e sipër.

Kërkesa për shkeljen e afatit të arsyeshëm

⇒ Në cilën gjykatë depozitohet kërkesa?

- Në sekretarinë e gjykatës, që është në vonesë ose gjykatës kompetente për ekzekutimin.

⇒ Cila gjykatë shqyrton kërkesën ?

- Gjykata kompetente (civile/ administrative) e apelit, kur çështja po gjykohet në gjykatën e shkallës së parë;
- Gjykata e Lartë, kur çështja po gjykohet në gjykatën e apelit (civil apo administrativ) ose në Gjykatën e Lartë;
- Gjykata e shkallës së parë kompetente për ekzekutimin, kur çështja është në fazën e ekzekutimit.

⇒ Cili është afati për gjykimin e kërkesës?

- Brenda 45 ditëve nga depozitimi i saj.



Shpërblimi i dëmit për shkeljen e afatit të arsyeshëm

⇒ Kërkohej me anë të një kërkesëpadi për shpërblim dëmi:

- Brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes me vendim të formës së prerë.

⇒ Ndaj kujt ngrihet kjo kërkesëpadi?

- Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave ose shërbimit përbarimor privat përgjegjës.

⇒ Gjykata kompetente për shpërblimin e dëmit:

- ⇒ Gjykata civile e shkallës së parë, ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja.

⇒ Masa e shpërblimit të dëmit:

- Nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, për çdo vit, ose muaj në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm.

⇒ Afati për gjykimin e kësaj kërkesëpadi:

- Brenda 3 muajve nga depozitimi i saj.



Paditë me vlerë të vogël

⇒ Çfarë kuptojmë me padi me vlerë të vogël?

- Paditë që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, vlera e objektit të të cilave është deri në 150.000 lekë.



⇒ Cilat janë rregullat e zhvillimit të këtyre padive?

- Zhvillimi i gjykimit të padisë tërësisht me shkrim;
- Përdorimi i mjeteve të komunikimit elektronik për dëgjimin e palëve;
- Marrja e dëshimve me anë të deklarimeve me shkrim ose videokonferencës;
- Mosarsyetimi i vendimit, nëse palët brenda tre ditëve nga komunikimi i vendimit nuk njoftojnë gjykatën me shkrim se do ta ankimojnë atë;
- Moslejimi i rekursit kundër vendimeve të gjykatës së apelit për këto padi.



FINANCIAR NGA:

FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË